



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 14667 Prot

Lezhë, më 30 / 08 /2022

VENDIM  
Nr. 94, Datë 29 . 08 .2022

**“PËR  
MIRATIMIN E MARRËVESHJES DHE PJESËMARRJEN E BASHKISË LEZHË NË  
SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QËLLIM KRYERJEN E  
SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT  
DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA”**

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të Nenit 9, dhe të pikës 1 dhe 5, të Nenit 14 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave 302 date 11.05.2022 “Per politikat kombetare per riorganizimin e sektorit te furnizimit me uje dhe largimit, trajtimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura”, Marrëveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës-Kanalizimeve date 22.07.2022 lidhur ndërmjet Bashkise Lezhë dhe MIE dhe Bashkive Kurbin dhe Mirditë , Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.56, datë 13.06.2022 “Për pjesëmarrjen e Bashkisë Lezhë në Subjekte me kompetenca të Përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Marrëveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës-Kanalizimeve datë 22.07.2022 lidhur ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe MIE dhe Bashkive Kurbin dhe Mirditë.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë z.Pjerin Ndreu në cilësinë e tij si aksionar i vetëm i Shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Sh.a Lezhë”, UK, që në përputhje me kushtet dhe dakordësinë e arritur në Marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës-Kanalizimeve datë 22.07.2022, që pas krijimit të Subjekteve të Kompetencave të Përbashkëta ku Bashkia do të jetë aksionare, të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionareve të autorizimit për Administratorin e Shoqërisë Aksionare UK “Ujësjellës-Kanalizimeve Sh.a Lezhë” z.Zef Maçi për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktor dhe notarial me qëllim transferimin e plotë të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë asetet që aktualisht shoqëria ka, për tek shoqëria e re SKP-UK që do të krijohet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI



K. B

Nr. 14687 prot  
Dt. 07.09.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 624/2 Prot.

Lezhë, më 06.09.2022

Lënda: Konfirmim vendimi

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", nenin 14 e vijues të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, VKM-nr.302, datë 11.05.2022 "Për praktikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të Vendimit nr.94, datë 29.08.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për miratimin e marrëveshjes dhe pjesëmarrjen e bashkisë Lezhë në subjekte me kompetenca të përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura".

